



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 4 nëntor 2019
Nr. ref.: RK 1464/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI73/19

Parashtrues

Hamzë Fekaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit,
AA.nr.506/2018, të 12 shkurtit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Hamzë Fekaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Skenderaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, AA.nr.506/2018, të 12 shkurtit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafin 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 7 maj 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 10 maj 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 27 maj 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës KI73/19 dhe një kopje të saj ia dërgoi Gjykatës së Apelit.
8. Më 8 tetor 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 18 prill 2017, parashtruesi i kërkesës ushtroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i pensioneve (në tekstin e mëtejme: MPMS), përmes së cilës kërkoi anulimin e vendimit të kësaj të fundit, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e tij për njohjen e të drejtës së pensionit kontributpagues të moshës.
10. Më 12 korrik 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë, departamenti për çështje administrative, me Aktgjykimin A.nr.726/2017, refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi ligjshmërinë e vendimit të MPMS-së, me arsyetimin si në vijim: *“Duke analizuar kriterin ligjor në nenin 8 pika 1.3 Gjykata verën se në mënyrë qe autoriteti publik të vendos për të drejtën e pensionit kontributdhënës pala duhet të ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin*

Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999. Nga shkresat e lëndës Gjykata gjen, siç është konstatuar edhe në vendimin e organit të paditur se pala paditëse nuk ka deponuar dëshmi (libreza e punës) për kontributet në kohëzgjatje prej 15 viteve. Andaj Gjykata gjen se vendimi i organit të paditur në këtë çështje administrative është ligjërisht i drejtë.”

11. Më 28 gusht 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të shkeljeve esenciale të ligjit procedural, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave të ligjit material.
12. Më 12 shkurt 2019, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin AA. nr. 506/2018, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak se i njëjti nuk kishte bashkëngjitur dëshmi për plotësimin e kritereve të kërkuar me ligj.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 të Kushtetutës, sepse: *“Ne rastin tim nuk është zbatuar drejtë Ligji 04/L-131, neni 8 paragrafi 6, ku thuhet qartë citoi: u njihet përvoja për vitet 1990-1999 punëtoreve të arsimit, shëndetësisë dhe të tjerëve të cilët kanë punuar në ish institucionet e Republikës së Kosovës. Konsideroj se në këtë rast është shkelur neni 3 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.”*
14. Për më tepër, parashtruesi pretendon si në vijim: *“Konsideroi përkundër qe të dy këto instanca të gjykatave nuk kanë vendosur drejtë, nuk kanë analizuar të gjitha provat, dhe nëse sipas tyre kanë analizuar të gjitha provat, atëherë ligjet të cilat kanë për objekt këtë lami janë diskriminuese, nga fakti se një kategori ia pranojnë të gjitha, si është Arsimi, ndërsa kategorive tjera ua mohojnë të gjitha, për çka konsideroi se edhe kjo gjykatë duhet të vlerësoi këtë ligjshmëri të këtyre Aktgjykimeve...”*
15. Në fund, parashtruesi nga Gjykata kërkon si në vijim: *“Ne këtë çështje Administrative kam kërkuar qe mua të me njihet përvoja e punës dhe vitet e kaluara në punë nga fakti se edhe unë nga pushteti i atëhershëm serbë i vendosur në Kosovë, për shkaqe politike jam largua nga puna e rregullt në vitin 1990, menjëherë pas kësaj jam angazhuar në Këshillin Financiar të Kosovës, aty kam punuar një periudhe të caktuar, dhe në tërësi kam përvojë pune më tepër se 20 vite, ndërsa gëzoi pensionin në lartësi prej 70,00 E.”*

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1, 7 dhe 8, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

1. *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

7. *Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

8. *Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë.”*

18. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet: 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtuesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtuesi dëshiron ta kontestojë.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtuesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

19. Gjykata më tutje shqyrton gjithashtu nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullin 39, konkretisht me nënregullin (1), shkronjën (a) dhe nënregullin (2) të Rregullores, që përcaktojnë:

Rregulli 39
Kriteret e pranueshmërisë

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar,

[...]

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtguesi nuk dëshmon dhe mbështetet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

20. Gjykata vëren se pretendimet e parashtguesit të kërkesës kanë të bëjnë me dy çështje: e para, sipas parashtguesit gjykatat e rregullta shkelen të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], për shkak se ato nuk i analizuan mirë provat dhe nuk i zbatuan drejtë dispozitat e Ligjit 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti dhe e dyta, sipas parashtguesit të kërkesës dispozitat e ligjit në fjalë janë diskriminuese dhe rrjedhimisht jokushtetuese, sepse e drejta në pension kontributpagues i njihet vetëm një kategorie të punëtoreve, përkatësisht arsimit, ndërsa kategorive të tjera (të cilët kanë punuar në vitet 1990 -1999), iu mohohet.
21. Sa i përket pretendimeve në lidhje me shkeljen e të drejtës së barazisë para ligjit, Gjykata vë në dukje se këto pretendime parashtguesi i ndërlidhë me mënyrën se si gjykatat e rregullta i administruan provat e prezantuara dhe se si ato interpretuan dhe zbatuan dispozitat përkatëse të ligjit.
22. Në lidhje me të drejtën për barazi para ligjit, Gjykata thekson qëndrimin e saj të përgjithshëm parimor se trajtimi është i pabarabartë dhe diskriminues nëse një individ trajtohet ndryshe nga të tjerët në pozita ose situata të njëjta dhe nëse ky ndryshim në trajtim nuk ka ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Për të qenë i arsyetuar, trajtimi i ndryshëm në rrethana të njëjta duhet të ndjekë një qëllim legjitim dhe duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti, midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet (shih rastin e GJEDNJ, *Marckx kundër Belgjikës*, Kërkesa nr. 6833/74, Aktgjykimi i 13 qershorit 1979, paragrafi 33).
23. Në dritën e kësaj, Gjykata verën se pretendimeve të parashtguesit të kërkesës në lidhje me administrimin e provave, Gjykata e Apelit i është përgjigjur me arsyetimin vijues: *“Nga provat e administruara rezulton se paditësi në kuptim të nenit 8 të Ligjit 04/L-131, nuk ka bashkangjitur të dhëna për 15 vite stazh kontributiv. Andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave nuk i ka plotësuar kushtet për realizimin e të drejtës për pension kontributpagues të moshës, konform dispozitave të lartcekura të Ligjit nr.04/L-131, për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Prandaj, nga këto arsye kolegji i kësaj gjykate vlerëson se vendimi i kontestuar është i drejtë dhe i bazuar, se ka mbështetje në provat e administruara, si dhe janë dhënë arsye të mjaftueshme nga gjykata e shkallës së parë, të cilat arsye edhe kolegji i kësaj gjykate i pranon.”*

24. Nga arsyetimi i mësipërm i Gjykatës së Apelit, Gjykata verën se kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës është refuzuar për arsye se i njëjti nuk kishte dëshmuar, me prova, se ai në bazë të ligjit të zbatueshëm i plotësonte kushtet e kërkuara për njohjen e të drejtës së kërkuar me kërkesëpadi.
25. Në këtë këndvështrim, Gjykata konsideron se vendimet e gjykatave të rregullta nuk përmbajnë elemente të shkeljes së barazisë para ligjit, përkatësisht elemente të trajtimit të pabarabartë, siç pretendon parashtruesi i kërkesës. Për më tepër, asnjë nga bazat e kërkuara të nenit 3 të Kushtetutës nuk e mbështesin pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e kësaj të drejte, sepse ai nuk dëshmon se gjykatat e rregullta e trajtuan atë në mënyrë të pabarabartë në krahasim me individë apo kategori individësh të tjerë, që gjenden në rrethana apo situatë të njëjta me parashtruesin.
26. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur ta mbështes pretendimin e tij në baza kushtetuese se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit shkel të drejtën e tij për barazi para ligjit, siç garantohet me nenin 3 të Kushtetutës.
27. Gjykata vë në pah se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, paragrafi 21, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005; shih Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, në rastin: KI25/11, me parashtrues *Shaban Gojnovci*, të 28 majit 2012, paragrafi 28; shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
28. Sa i përket pretendimit të dytë të parashtruesit të kërkesës, se dispozitat e Ligjit 04/L-131 janë diskriminuese, sepse me të njëjtat vetëm disa kategorive të “caktuara” dhe jo të “gjithave” iu njihet përvoja e punës, përkatësisht njohja e kontributeve pensionale të moshës, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës këtë pretendim nuk mund të ngrejë drejtpërdrejtë në Gjykatën Kushtetuese. Në fakt, kjo e drejtë e kontestimit të kushtetutshmërisë së një dispozite të një ligji është e paraparë me dispozita të tjera kushtetuese, përkatësisht me nenin 113.8 të Kushtetutës (nëpërmjet të ashtuquajturit “kontrolli incidental i kushtetutshmërisë”).
29. Këtë të drejtë parashtruesi i kërkesës ka mundur ta shfrytëzojë gjatë shqyrtimit të çështjes së tij në gjykatat e rregullta, duke iu referuar nenit 113, paragrafit 8., të Kushtetutës. Sipas këtij neni të Kushtetutës, individët (personat fizik dhe juridik) gëzojnë të drejtën e kontestimit të kushtetutshmërisë së një dispozite të një ligji, e cila është drejtpërdrejtë e zbatueshme në rastin e tij/saj nga gjykatat e rregullta. Por këtë, individët mund ta bëjnë vetëm gjatë procedurës në gjykatat e rregullta, të cilat mandej kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të ligjit në fjalë (shih, *mutatis mutandis*, vendimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet: KO126/16, parashtrues *Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit*, të 27 marsit 2017; KO142/16, parashtrues *Kolegji i Apelit i*

Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 9 majit 2017 dhe rastin KO157/18, parashtrues Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, të 13 marsit 2019).

30. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk e ka përmbushur kriterin e palës së autorizuar sipas nenit 113, paragrafi 1. të Kushtetutës dhe rregullit 39, nënregullit (1), shkronjës (a) të Rregullores së punës për të kontestuar drejtpërdrejtë kushtetutshmërinë e një dispozite konkrete të një ligji në Gjykatë (shih, ngjashëm, Gjykata Kushtetuese, në rastin *KI05/17, parashtrues: Osman Syllanaj*, Aktvendimi për papranueshmeri i 3 korrikut 2017, paragrafët 22 dhe 23).
31. Si përfundim, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata arrin në përfundim se kërkesa e parashtruesit të kërkesës:
 - (i) përkitazi me pretendimin e parë, se gjykatat e rregullta nuk analizuan mirë provat dhe nuk zbatuan drejtë ligjin e aplikueshëm, me ç'rast shkelën të drejtat e tij të mbrojtura me nenin 3 [Barazia para Ligjit], të Kushtetutës, në baza kushtetuese, duhet të shpallet e papranueshme, si qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës;
 - (ii) përkitazi me pretendimin e dytë, se dispozitat e Ligjit 04/L-131 janë diskriminuese, kërkesa duhet të shpallet gjithashtu e papranueshme, sepse parashtruesi i kërkesës nuk e përmbushë kriterin e palës së autorizuar, siç kërkohet me nenin 113, paragrafin 1. të Kushtetutës dhe me rregullin 39, nënregullin (1), shkronjën (a) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (1) (a), 39 (2), dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 8 tetor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi